



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

Nr. 4050 Prot

Dt. 17.07.2026

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti : "Për blerje të mjeteve me funksion të veçantë për përballim të emergjencave civile dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës në Bashkinë Tropojë"

Në zbatim të Urdhrit Nr. 152, datë 02.06.2026, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimet teknike", si dhe të Urdhrit Nr. 152/1, datë 15.07.2026, "Për ndryshimin e anëtarës në grupin e punës për hartimin e dokumenteve për fondin limit dhe specifikimet teknike", u konstituua grupi i punës për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për procedurën e prokurimit me objekt: **"Blerje të mjeteve të emergjencave civile dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës në Bashkinë Tropojë"**. Grupi i punës, në përbërjen e miratuar sipas urdhrave të sipërcituar, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, hartoi specifikimet teknike duke u mbështetur në nevojat e Autoritetit Kontraktor, kërkesat funksionale dhe teknike të mallrave që do të prokurohen, si dhe standardet përkatëse të cilësisë dhe performancës.

Ky dokument ka për qëllim përcaktimin e kërkesave teknike për mallrat objekt prokurimi, në mënyrë të qartë, të plotë dhe të paanshme, duke garantuar zhvillimin e një procedure prokurimi në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

Mjetet objekt i procedurës së prokurimit duhet të jenë të pajisura me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, të nevojshëm për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare përkatëse.

Në çmimin e secilit mjet duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet e nevojshme për vënien e tij në qarkullim dhe përdorim, përfshirë, por pa u kufizuar në: taksat doganore, regjistrimin, siguracionin, targat, kontrollin teknik, taksat e ndryshme, shpenzimet noteriale për kalimin e pronësisë, si dhe çdo shpenzim tjetër të domosdoshëm deri në dorëzimin përfundimtar në destinacionin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë.

Mjetet duhet të mbulohen me garanci teknike minimale prej 1 (një) viti, nga data e marrjes në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor. Kjo garanci kërkohet për të siguruar funksionimin normal të mjeteve gjatë periudhës së përdorimit dhe për të mundësuar verifikimin dhe testimin teknik të tyre në kushte pune.

Mjetet duhet të dorëzohen tërësisht të shërbyera (me ndërrim vajrash, filtrash dhe çdo shërbim tjetër teknik të nevojshëm) në momentin e dorëzimit.

Mjetet e përdorura, objekt i kësaj procedure prokurimi, do të pranohen përfundimisht vetëm pas kolaudit nga një komision i posaçëm i ngritur nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Afati i kolaudit (provat dhe testimet në terren) nuk duhet të tejkalojë 7 (shtatë) ditë kalendarike ose 5 (pesë) ditë pune.

Shënim: Mjetet e përdorura (me kilometrazh/ore pune më shumë se 0):

Mjetet duhet të jenë në gjendje shumë të mirë motorike, xhenerike dhe vizuale në pjesën e brendshme/jashtme dhe duke mos pasur dëmtime sidomos për sa i përket korrozionit, dëmtimet nga agjentët atmosferikë, goditjet etj.

Tubat e presionit të vajit, të jenë në gjendje të mirë (të pa gripuara). Gomat të jenë në gjendje të mirë (jo të konsumuara).

LOTI III-TË: “BLERJE MJETE NIVELIMI”

1. RUL NGJESHËS

Specifikimet Teknike

- Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2012
- Orë pune: Maksimumi 6,000 orë
- Peshë e punës: Minimumi 10.000 (kg)
- Diametri rullit: Minimumi 2.1 m
- Motor Diesel jo më pak se 100HP
- Sistem vibrimi me të paktën 2 amplituda pune
- Lënda djegëse: Naftë
- Fuqia: Minimumi 68 kw
- Sistemi i drejtimit: Hidraulik
- Rrota vibruese: Përpara
- Konfigurimi: Hekur/Gomë
- Sistemi i frenimit: Hidrostatik
- Kabina: Kundër vibrimit
- Drita pune: Para/Mbrapa
- Buton STOP për emergjencë
- Alarm për ecje mbrapa
- Shpejtësia e levizjes: minimum 10 km/orë

Argumentimi

Pika 1-2 – Është përcaktuar që mjeti të jetë i përdorur, në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, me vit prodhimi jo më herët se viti 2012 dhe me maksimumi 6,000 orë pune, me

qëllim garantimin e një jetëgjatësie të mjaftueshme operacionale dhe minimizimin e kostove të mirëmbajtjes.

Pika 3-4 – Pësja operative dhe dimensionet e tamburit janë përcaktuar për të garantuar ngjeshjen efektive të shtresave të rrugëve rurale, rrugëve të parcelave dhe sipërfaqeve të tjera ku do të përdoret mjeti.

Pika 5-6-7 – Fuqia minimale e motorit dhe përdorimi i lëndës djegëse naftë sigurojnë performancë të lartë pune, konsum ekonomik të karburantit dhe kosto më të ulëta operimi.

Pika 8-15 – Sistemi vibrues, sistemi hidraulik i drejtimit, frenimi hidrostatik, kabina kundër vibrimit, sinjalistika e sigurisë dhe pajisjet ndihmëse janë kërkuar për të garantuar siguri, komoditet dhe efikasitet maksimal gjatë procesit të punës.

2. FADROMË

Specifikimet Teknike

- Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2005.
- Orë pune: Maksimumi 6,000 orë.
- Mënyra e lëvizjes: Me goma.
- Pësja e mjetit: 8–11 ton.
- Rendimenti i fuqisë: Minimumi 70 kw.
- Lënda djegëse: Naftë.
- Norma e emetimit: Minimumi Tier 3.
- Lartësia maksimale operative: Minimumi 6 m.
- Thellësia e gërmimit: Minimumi 5.5 m.
- Zgjatja horizontale: Minimumi 7.5 m.
- E pajisur me 3 kova gërmimi 30-40 cm, 60-70 cm dhe 90-100 cm.
- Kovë multifunksionale përpara me kapacitet minimumi 1 m³.
- Pirunë ngritës të integruar.
- Kapje e shpejtë për veglat e punës.
- Stabilizues hidraulikë.
- Sistem kondicionimi (A/C).
- Pajisur me sistem monitorimi në distancë.
- Numri I gomave 16.9.28

Argumentimi

Pika 1-2 – Është përcaktuar që mjeti të jetë i përdorur, në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, me vit prodhimi jo më herët se viti 2005 dhe maksimumi 10,000 orë pune, për të garantuar një raport të drejtë midis kostos së blerjes dhe performancës operative.

Pika 3 – Lëvizja me goma mundëson transport më të shpejtë të mjetit ndërmjet objekteve të punës dhe rrit fleksibilitetin operacional.

Pika 4 – Pesha operative siguron stabilitet, forcë ngritëse dhe performancë optimale gjatë proceseve të gërmimit dhe ngarkimit.

Pika 5 – Fuqia minimale 70 kw është kërkuar për të përballuar volumet e punës së parashikuara dhe për të garantuar rendiment të lartë.

Pika 6-7 – Përdorimi i motorit me naftë dhe norma e emetimit Tier 3 sigurojnë ekonomi karburanti dhe reduktim të ndikimit në mjedis.

Pika 8 – Parametrat e gërmimit janë përcaktuar bazuar në natyrën e punimeve që do të kryhen në territorin e institucionit.

Pika 9 – Kovat e dimensioneve të ndryshme dhe kova multifunksionale mundësojnë kryerjen e proceseve të ndryshme të punës me efikasitet maksimal. Kapja e shpejtë, stabilizuesit hidraulikë dhe sistemi A/C rrisin produktivitetin dhe komoditetin e operatorit.

Pika 10 – Sistemi i monitorimit në distancë mundëson kontroll më të mirë të përdorimit të mjetit dhe rrit efikasitetin në administrimin e flotës.

3.MINIESKAVATOR 3-5 TON

Specifikimet teknike

- Viti i prodhimit: jo më herët se viti 2010
- Orë pune: maksimumi 6,000 orë pune
- Fuqia motorrike: minimumi 25–40 kw
- Pesha operative: 3 – 5 ton
- Lloji i karburantit: naftë (diesel)
- Norma e emetimit: minimumi Tier 3 / Tier 4 Final ose ekuivalent
- Sistemi i lëvizjes: zinxhir gome
- Lartësia e gërmimit: minimumi 5.5 – 6 m
- Thellësia e gërmimit: minimumi 3.5 – 4 m
- Zgjatja horizontale: minimumi 5.5 – 6.5 m
- Rrotullimi i krahut majtas: minimumi 50° – 55°
- Rrotullimi i krahut djathtas: minimumi 55° – 60°
- 2 kova gërmimi:
 - 30–40 cm
 - 60–70 cm
- 1 kovë për pastrim kanalesh: 100–140 cm
- Linja hidraulike ndihmëse
- Sistem kapje e shpejtë (quick coupler)
- Valvula sigurie në cilindrat e krahëve
- Thikë (blade) përpara
- Kamera e pasme
- Sistem A/C (ajër i kondicionuar)
- Sistem monitorimi në distancë (telematikë)

Argumentimi

Pika 1–2 – Është përcaktuar që mjeti të jetë i përdorur, në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, me vit prodhimi jo më herët se viti 2010 dhe me maksimum 6,000 orë pune, për të siguruar balancë midis kostos, jetëgjatësisë dhe performancës operacionale.

Pika 3 – Fuqia motorrike 25–40 kw është kërkuar për të garantuar kapacitet të mjaftueshëm pune në operacione gjërmimi, ngarkimi dhe sistemimi materialesh në terrene të ndryshme.

Pika 4 – Pesha operative 3–5 ton është përcaktuar për të siguruar manovrueshmëri të lartë, akses në hapësira të ngushta dhe përshtatshmëri në punime urbane dhe rurale.

Pika 5–6 – Lënda djegëse diesel dhe norma e emetimit Tier 3 / Tier 4 Final ose ekuivalent janë kërkuar për të siguruar ekonomi në konsum dhe respektim të standardeve mjedisore.

Pika 7 – Sistemi me zinxhir gome është kërkuar për të minimizuar dëmtimin e sipërfaqeve dhe për të rritur stabilitetin gjatë punës.

Pika 8 – Parametrat e gjërmimit dhe rrotullimi i krahut janë vendosur për të siguruar fleksibilitet maksimal dhe efikasitet në operime të ndryshme.

Pika 9 – Pajisja me kova të ndryshme mundëson realizimin e punimeve të ndryshme si gjërmim, ngarkim dhe pastrim kanalesh.

Pika 10 – Linjat hidraulike, kapja e shpejtë, valvulat e sigurisë, thika e përparme, kamera e pasme dhe sistemi A/C rrisin sigurinë, komoditetin dhe produktivitetin e operatorit.

Pika 11 – Sistemi i monitorimit në distancë mundëson kontroll më të mirë të përdorimit të mjetit, menaxhim efikas të flotës dhe optimizim të mirëmbajtjes.

4. KAMION 2 AKS BORËPASTRUES

Specifikimet Teknike

- Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2015.
- Kilometrazhi: Maksimumi 250,000 km.
- Pesha totale e lejuar: Jo më pak se 18 ton.
- Sistem lëvizjeje: 4x4.
- Motor Diesel me fuqi jo më pak se 250 HP.
- Standard emetimesh: Minimumi Euro 5.
- Kambio manuale ose automatike.
- Teh borëpastrues frontal me gjerësi pune jo më pak se 2.8 m.
- Tehu të jetë me komandim hidraulik për ngritje, ulje dhe orientim.
- Shpërndarës kripe/rëre me kapacitet jo më pak se 4 m³.
- Sistem hidraulik për operimin e tehut dhe shpërndarësit.

- Kabinë e mbyllur me sistem ngrohjeje dhe kondicioner funksional.
- Pajisur me sinjalistikë dhe drita paralajmëruese për punë dimërore.
- Diferencial me bllokim.
- Pajisur me zinxhirë bore sipas dimensioneve të gomave.
- PTO (Power Take Off) për funksionimin e pajisjeve ndihmëse.
- Gjendje shumë e mirë motorike, mekanike dhe vizuale.
- Goma në gjendje të mirë pune.

Argumentimi

Pika 1-2 – Është përcaktuar që mjeti objekt prokurimi të jetë i përdorur, në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, me vit prodhimi jo më herët se viti 2015 dhe me kilometrazh të arsyeshëm për vitin e prodhimit. Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar besueshmëri, jetëgjatësi dhe gatishmëri operacionale gjatë sezonit dimëror.

Pika 3-4 – Pësia totale dhe sistemi i lëvizjes 4x4 ose 6x4 janë kërkuar për të siguruar lëvizshmëri, stabilitet dhe aftësi pune në kushte të vështira atmosferike, në rrugë malore dhe terrene me pjerrësi.

Pika 5-7 – Fuqia minimale 250 HP, përdorimi i lëndës djegëse naftë dhe standardi i emetimeve Euro 5 janë kërkuar për të garantuar performancë të lartë pune, ekonomi karburanti dhe respektim të standardeve mjedisore.

Pika 8-11 – Tehu frontal borëpastrues, shpërndarësi i kripës/rërës dhe sistemi hidraulik janë kërkuar për të siguruar kryerjen efektive të shërbimit të pastrimit të borës dhe trajtimit të akullit në rrugë.

Pika 12-15 – Kabina me ngrohje dhe kondicioner, sinjalistika paralajmëruese, diferenciali me bllokim, zinxhirët e borës dhe sistemi PTO janë kërkuar për të rritur sigurinë, funksionalitetin dhe efikasitetin e mjetit gjatë operimit në kushte dimërore.

Pika 16-17 – Gjendja e mirë motorike, mekanike dhe vizuale, si dhe gjendja e mirë e gomave, janë kërkuar për të garantuar marrjen në dorëzim të një mjeti të gatshëm për punë dhe funksionim normal.

5. Foristradë zjarrfikëse

Specifikimet Teknike

- Fuqia motorrike: minimumi 2500 cc.
- Sistemi i lëvizjes: 4x4.
- Numri i akseve: 2.
- Lënda djegëse: Diesel.
- Numri i dymve: 4.

- Numri i vendeve: minimumi 5 (4+1).
- Kapaciteti i depozitës së ujit: 300–500 litra.
- E pajisur me pompë centrifugale ose motopompë të instaluar.
- E pajisur me tub zjarrfikës cilësor, rezistent ndaj presionit dhe i pathyeshëm, me gjatësi minimumi 80 metra.
- E pajisur me sirenë dhe drita sinjalizuese.
- E pajisur me sistem ngrohjeje dhe kondicionimi (A/C).

Argumentimi

Pika 1-2 – Është kërkuar që mjeti të ketë fuqi motorrike minimumi 2500 cc dhe të përdorë lëndë djegëse Diesel, pasi këto karakteristika garantojnë fuqi të mjaftueshme, çift rrotullues të lartë, konsum ekonomik të karburantit dhe performancë të qëndrueshme gjatë transportit të ujit dhe pajisjeve zjarrfikëse, si dhe gjatë ndërhyrjeve në terrene të vështira.

Pika 3 – Sistemi i lëvizjes 4x4 me dy akse është kërkuar për të siguruar lëvizshmëri, stabilitet dhe aftësi operationale në rrugë malore, rurale, pyjore dhe në terrene të vështira, ku mund të ndodhin zjarre ose situata emergjente.

Pika 4-5 – Numri i dyerve 4 dhe kapaciteti prej minimumi 5 vende (4+1) janë kërkuar për të garantuar transportin e ekuipazhit dhe të pajisjeve të nevojshme për ndërhyrje, duke mundësuar operim të sigurt dhe efikas.

Pika 6 – Kapaciteti mbajtës i depozitës së ujit 300–500 litra është përcaktuar për të mundësuar ndërhyrje të menjëhershme në zjarret e vogla dhe në fazat fillestare të zjarreve, veçanërisht në zona ku automjetet zjarrfikëse të përmasave të mëdha nuk kanë akses.

Pika 7 – Pajisja me pompë centrifugale ose motopompë të instaluar është kërkuar për të garantuar furnizim të vazhdueshëm me ujë dhe presion të mjaftueshëm gjatë operationeve të fikjes së zjarrit.

Pika 8 – Pajisja me tub zjarrfikës cilësor, rezistent ndaj presionit dhe i pathyeshëm, me gjatësi minimumi 80 metra, është kërkuar për të mundësuar ndërhyrje në distancë nga automjeti, duke rritur efektivitetin dhe sigurinë gjatë operationeve të fikjes së zjarrit.

Grupi I Punës:

Fatbardh Metaliaj


Ndriçim Gjocaj

Fatmir Rexhaj

Ervin Demushi

Elizabeta Selimaj







MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË TROPOJË
 Rexhë BYBERI

